




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 483

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja s, nenin 39.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të 13.04.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.04.2011, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E 50 (PESËDHJETË)
BURSAVE DHE 20 (NJËZET) SHPËRBLIMEVE PËR STUDENTË TË
DALLUAR

I

Me këtë vendim miratohen Kriteret për ndarjen e 50 (pesëdhjetë) bursave për student të dalluar të Komunës së Gjilanit për vitin akademik 2010/2011, dhe atë si në vijim:

Kriteret e përgjithshme:

- Studentët që studiojnë në Universitete Publike.....2 poenë
- Studentët që studiojnë në Universitete Private1 poenë
- Shfrytëzues të bursave mundë të jenë vetëm studentët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Gjilanit
- Shfrytëzues të bursës studentore mundë të jenë vetëm studentët e rregullt
- Nuk do të ketë më shumë se dy bursa për profile të njëjta
- Studentët që janë shfrytëzues të bursës universitare apo ndonjë burse tjetër nuk mundë të jenë edhe shfrytëzues të kësaj burse
- Studentët që janë në marrëdhënie të përhershme pune nuk mundë të jenë përfitues të bursës

Kriteret e veçanta:

1. Nota mesatare 10 poentohet me 10 pikë nëse nuk e ka mbërri bursën e universitetit, të sillet vërtetimi
2. Nota mesatare 9 poentohet me 9 pikë
3. Nota mesatare 8 poentohet me 8 pikë
4. Nota mesatare 7 poentohet me 7 pikë
5. Në kushte të barabarta kategoritë: studentët të cilët janë fëmijë të dëshmorit, studentët që kanë qenë pjesëmarrës të UÇK-së, rastet sociale (të sillet vërtetimi nga enti për punësim, që nuk kanë të punësuar) do të poentohen me 1 pikë

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave (origjinale)
- Kopja e indeksit me të gjitha provimet e dhëna
- Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm
- Kopja e letërnjoftimit

- Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë, vëlla, motër i dëshmorit
- Certifikata mbi gjendjen e ekonomike në emër të prindit
- Vendimi mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2010/2011
- Vërtetimin e studenti/ja ka qenë pjesëtare e UÇK-së
- Vërtetimin se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2010/2011 (I rregullt)

II

Po ashtu me këtë vendim miratohen kriteret për ndarjen e 20 shpërblimeve për student të dalluar dhe atë si vijon:

- Përfshirja e gjitha profileve, nga secili profil nga një student
- Përfitues do të jenë ata student me mesataren më të lartë në konkurrencë brenda një profili
- Te studentët e një profili me kushte të barabarta do të merret për bazë mesatarja më e lartë e notave profesionale

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Drejtoria për Arsim, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit,

01.Nr. 16/5690
Gjilan, më 27.4.2011

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues